



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Nr. \_\_\_\_ Prot

Korçë, më 12.10.2023

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**  
**(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

*Datë 12.10.2023*

Drejtuar: *Shoqërisë "IGLI-SAND" sh.p.k adresa: Fshati Qerekë, Rruga kryesore, ndërtesë private 1 katëshe, zona kadastrale 3096 me nr pasurie 88/32, Qerekë, Krujë.*

Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar**

Numri i procedurës **REF-78852-09-01-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës :

Objekti: **Pajisje mobilierie per shkollen e arsimit të mesëm të përgjithshëm "Themistokli Gërmenji" Korçë**

Afati: **20 ditë kalendarike nga data e lidhjes te kontratës**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike: **Nr.77 Date 11.09.2023, Nr 84 Datë 09.10.2023**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

**oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. Shoqeria " IGLI-SAND" shpk, NIPT J94625209A me vleren:**

*3,564,500 (tre milion e peseqind e gjashtedhjetë e kater mije e peseqind)lekë, pa tvsh*

**2. Shoqeria " M. LEZHA" shpk, NIPT J76504013C me vleren:**

*3,868,500 (tre milion e teteqind e gjashtedhjetë e tete mije e peseqind)lekë, pa tvsh.*

**3. Shoqeria " ERALD" shpk, NIPT J74517205P me vleren:**

*4,191,695 (kater milion e njeqind e nentedhjetë e nje mije e gjashteqind e nentedhjetë e pese)lekë, pa tvsh.*

**4. Shoqeria " BUNA " shpk, NIPT J61826501C, me vleren:**

*Nuk ka paraqitur oferte ekonomike*

**5. Subjekti “ ILIR KASO“ p.f, NIPT L62420034C me vleren:**

*4,200,000 (kater milion e dyqind mije)lekë, pa tvsh.*

**6. Shoqëria “ SHAGA.” shpk, NIPT J96822229J me vleren:**

*4,458,990 (kater milion e katerqind e pesedhjete e tete mije e nenteqind e nenentedhjete)lekë, pa tvsh.*

**7. Shoqëria “ ERZENI/SH” shpk, NIPT J66902027T me vleren:**

*4,659,060 (kater milion e gjashteqind e pesedhjete e nente mije e gjashtedhjete)lekë, pa tvsh.*

**8. Shoqëria “ E M K O” shpk, NIPT K61424016V me vleren:**

*4,811,700 (kater milion e teteqind e njembedhjete mije e shtateqind)lekë, pa tvsh.*

**9. Shoqëria “ EUROCOMERCE-AIPg” shpk, NIPT L24616001M me vleren:**

*4,973,700 (kater milion e nenteqind e shtatedhjete e tre mije e shtateqind)lekë, pa tvsh.*

**10. Shoqëria “ RO -AL” shpk, NIPT J61811001M me vleren:**

*4,988,000 (kater milion e nenteqind e tetedhjete e tete mije )lekë, pa tvsh.*

**11. Shoqëria “ SARK” shpk, NIPT K52531415H. me vleren:**

*5,083,500 (pese milion e tetedhjete e tre mije e peseqind)lekë,pa tvsh*

**12. Shoqëria “ BAJRO BROS” shpk, NIPT M11313029O me vleren:**

*5,088,550 (pese milion e tetedhjete e tete mije e peseqind e pesedhjete)lekë, pa tvsh.*

**13. Shoqëria “ BOLT” shpk, NIPT K91517011V me vleren:**

*5,415,000 (pese milion e katerqind e pesembedhjete mije )lekë, pa tvsh.*

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**1. Shoqëria “ BUNA ” shpk, NIPT J61826501C, për arsye se:**

*Ofertuesi nuk ka dorezuar asnje nga dokumentat e kerkuara dhe as oferte ekonomike.*

**2. Subjekti“ ILIR KASO“ p.f, NIPT L62420034C për arsye se:**

*1.Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit,shtojca 7,kriteret e vecanta te kualifikimit 2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale: 2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes te njoftimit te kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .*

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

- a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
- b) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*Konkretisht ofertuesi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të vërtetojë kryerjen e furnizimeve të ngjashme.*

*2. Perfaqesi i subjektit “Ilir Kaso” p.f, Z. Ilir Kaso figuron ortak në shoqërine Roal sh.p.k e cila është gjithashtu ofertuese në këtë procedurë. Kjo bie në kundërshtim me nenin 81 të VKM Nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet shprehimisht se:*

1. *Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.*
2. *Ndërhyrje në ofertë do të konsiderohet edhe pjesëmarrja e dy ose më shumë ofertuesve me të njëjtin ortak dhe/ose administrator në të njëjtën procedurë prokurimi.*

### **3. Shoqëria “ E M K O” shpk, NIPT K61424016V për arsye se:**

*Ofertuesi ka paraqitur sigurimin e ofertes me afat vlefshmërie 20 ditë, ç’ka bie në kundërshtim me përcaktimin e bere në dokumentat e tenderit, njoftimi i kontrates pika 3.2.ku është përcaktuar shprehimisht: “**Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 ditë**”.*

### **4. Shoqëria “ RO -AL” shpk, NIPT J61811001M për arsye se:**

*2. Shoqëria Roal sh.p.k ka ortak Z. Ilir Kaso i cili është perfaqesi i subjektit “Ilir Kaso” p.f, i cili është gjithashtu ofertues në këtë procedurë. Kjo bie në kundërshtim me nenin 81 të VKM Nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet shprehimisht se:*

1. *Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.*
2. *Ndërhyrje në ofertë do të konsiderohet edhe pjesëmarrja e dy ose më shumë ofertuesve me të njëjtin ortak dhe/ose administrator në të njëjtën procedurë prokurimi.*

### **5. Shoqëria “ Sark ” shpk, NIPT K52531415H për arsye se:**

1. Nuk plotëson kriterin e vendosur në dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta të kualifikimit 2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale: 2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

- a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Konkretisht ofertuesi për plotësimin e këtij kriteri ka paraqitur kontratën me objekt **“Punime ndertimore në kuader të rehabilitimit të qendres aktuale dhe ngritjes së infrastruktures” të lidhur me Bashkinë Korçë. Kjo kontratë nuk është e ngjashme me objektin e prokurimit.**

\*\*\*\*\*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë **“IGLI-SAND”sh.p.k me adresë: Fshati Qerekë, Rruga kryesore, ndërtesë private 1 katëshe, zona kadastrale 3096 me nr pasurie 88/32, Qerekë, Krujë**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **3,564,500 (tre milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e kater mijë e pesëqind)lekë, pa tvsh**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Bashkisë Korçë, Drejtoria e Prokurimeve*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi por jo më vonë se 5 dite nga kërkesa e për lidhjen e kontratës.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe do të vijohet siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

**Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak):**

PO       **JO x**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
SOTIRAQ FILO**